



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / *Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta*

Ministry of Culture, Youth & Sports

Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive

KOMUNIKATË PËR OPINIONIN PUBLIK

06 Maj 2021

Prishtinë

Këshilli për Sport – Komunikatë për Opinionin Publik

Sot, më datë 6 maj, u mbajt takimi i jashtëzakonshëm i Këshillit Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive të Tjera Negative në Ngjarjet Sportive. Qëllimi i takimit ishte adresimi i ngjarjes së fundit në ndeshjen e basketbollit, mes klubeve 'KB Ponte' nga Prizreni dhe 'KB Peja'. Në takim ka marrë pjesë edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku, zëvendësministrja e MKRS -së, znj. Daulina Osmani dhe në bazë të çështjes për diskutim, ka marrë pjesë edhe kryetari i Federatës së Basketbollit, z. Arben Fetahu.

Rastet e dhunës në sport janë çështje që Këshilli i trajton me seriozitetin më të lartë. Nga njoftimi i rastit të ndodhur në Prizren, Këshilli ka kërkuar nga Prokuroria hetimin e plotë të rastit e cila ka njoftuar se tashmë një gjë e tillë ka filluar dhe deri më tani, ndaj disa personave, Prokuria e Prizrenit, ka shqiptuar masën e ndalimit prej 48 orë.

Policia e Kosovës dhe autoritetet tjera të sigurisë poashtu kanë njoftuar se janë duke bërë verifikimin e informatave dhe identifikimin e të gjithë personave të përfshirë përmes intervistimeve dhe mbledhjes së provave.

Sot, në kuadër të takimit të jashtëzakonshëm anëtarët e Këshillit kanë pranuar inçizime shtesë të cilat tashmë janë proceduar në Prokurori. Më tutje Këshilli do të përcjellë rastin në vazhdimësi deri në zbardhjen e tij.

Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive të Tjera Negative në Ngjarjet Sportive, ritheksoi vendosmërinë për të ndërmarrë të gjitha veprimet në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të tij për të bashkëpunuar me të gjitha autoritetet relevante me qëllim që adresimi i përgjegjësi ndaj atyre që përfshihen në akte të dhunës dhe dukurive tjera negative në ngjarjet sportive, të jetë i plotë dhe proporcional me veprimet e kundërligjshme.

Këshilli po ashtu i dha mbështetje reagimit të Federatës së Basketbollit, në adresimin e përgjegjësisë disiplinore dhe organizative ndaj palëve të përfshira në këtë rast.

Po ashtu, javën e kaluar Këshilli ka mbajtur një takim për të adresuar shqetësimet e fundit lidhur me kurdisjet e mundshme në ndeshjet e futbollit. Kurdisjet paraqesin problem serioz dhe të gjitha pretendimet duhet të mbështeten në fakte dhe trajtimi i secilit rast duhet të bëhet në përputhje me ligjet në fuqi.

Me respekt,

Besim Kelmendi

Kryetar i Këshillit për Sport

Tel: +383 44 666 913 (edhe në Viber)

Email: keshillipersport@rks-gov.net

Web: <https://mkrs-ks.org/?page=1,176>